

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 Gusht 2010), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 03 prill 2017), si dhe nenet 16 dhe 85 të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2025, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SHITESAT MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të definoj dhe përcaktoj Shtesat Makroprudenciale të Kapitalit, në funksion të mbikëqyrjes makroprudenciale.
2. Kjo Rregullore zbatohet nga të gjitha bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - 1.1. **Shtesa kundërciklike e kapitalit (ang: Countercyclical Capital Buffer)** – nënkupton sasinë e kapitalit bazë të klasit të parë që një bankë është e detyruar të mbajë në përputhje me nenin 3 të kësaj Rregullore;
 - 1.2. **Shtesa kundërciklike specifike për bankën (ang: Bank-specific Countercyclical Buffer)** – nënkupton sasinë e kapitalit bazë të klasit të parë që një bankë është e detyruar të mbajë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj Rregullore;
 - 1.3. **Shtesa për institucionet tjera me rëndësi sistemike (ang: O-SII Buffer)** – nënkupton sasinë e kapitalit bazë të klasit të parë që bankat me rëndësi sistemike janë të detyruara të mbajnë në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregullore;
 - 1.4. **Shtesa e rrezikut sistemik (ang: Systemic Risk Buffer)** – nënkupton sasinë e kapitalit bazë të klasit të parë që një bankë është e detyruar të mbajë në përputhje me nenin 5 të kësaj Rregullore;
 - 1.5. **Shtesa e kombinuar e kapitalit (ang: Combined Buffer Requirement)** – nënkupton gjithsej kapitalin bazë të klasit të parë që është i nevojshëm për të përmbushur kërkesat për të gjitha shtesat e aplikueshme makroprudenciale të kapitalit.

Neni 3

Shtesa Kundërciklike e Kapitalit

1. Bankat duhet të mbajnë një shtesë kundërciklike të kapitalit në kapitalin bazë të klasit të parë (CET 1), ekuivalente me vlerën e përgjithshme të ekspozimeve të peshuara me rrezik, të shumëzuara me normën e shtesës kundërciklike, specifike për bankën referuar në paragrafin 2 të këtij neni, në baza individuale dhe të konsoliduara.
2. Norma e shtesës kundërciklike specifike për bankën është mesatarja e ponderuar e normave të shtesës kundërciklike të kapitalit të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe në juridiksionet e tjera në të cilat banka ka ekspozime materiale, e peshuar me sasinë e përgjithshme të ekspozimeve të peshuara me rrezik të juridiksioneve përkatëse.
3. BQK-ja do të përcaktojë normën e shtesës kundërciklike për ekspozimet e bankave në Republikën e Kosovës, e shprehur si përqindje ndaj vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të peshuara me rrezik, në intervalin 0% - 2.5%, e kalibruar në hapa prej 0.25 pikë përqindje, ose si shumëfish i plotë i 0.25 pikë përqindje. Megjithatë, BQK-ja mund të vendosë një normë të shtesës kundërciklike mbi 2.5% të vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të peshuara me rrezik, kur kjo justifikohet në bazë të vlerësimit të referuar në paragrafin 7 të këtij neni.
4. Për ekspozimet materiale në juridiksione të tjera, bankat do të përdorin normën e shtesës kundërciklike të vendosur nga autoriteti makroprudencial përkatës për atë juridiksion, përveç në rastin kur BQK-ja ka shpallur një normë tjetër siç referohet në paragrafin 10 të këtij neni. Parimi i materialitetit do të nënkuptojë se bankat do të marrin në konsideratë normat e shtesës kundërciklike të juridiksioneve të tjera vetëm në rastet kur ekspozimet e tyre ndaj atyre juridiksioneve tejkalojnë 2% të vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të peshuara me rrezik. Kur ekspozimet e tilla përbëjnë më pak se 2% të vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të peshuara me rrezik, norma specifike për bankën do të jetë e barabartë me normën e vendosur nga BQK-ja për ekspozimet në Republikën e Kosovës.
5. Për qëllimet e llogaritjes së normave të shtesës specifike për bankat sipas paragrafit 2 të këtij neni, një bankë duhet të identifikojë lokacionet gjeografike të të gjitha ekspozimeve kreditore të saj dhe të ofrojë regjistër adekuat të normave të shtesës kundërciklike të kapitalit të aplikueshme në ato vende, duke përfshirë procedurat e vendosura për përditësimin e rregullt të këtij regjistri.
6. Bankat nuk mund të përdorin kapitalin bazë të klasit të parë (CET 1) që mbahet për të plotësuar kërkesën sipas paragrafit 1 të këtij neni për të përmbushur asnjë nga kërkesat e vendosura sipas neneve 4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje, apo ndonjë kërkesë shtesë të vendosur si pjesë e masave mbikëqyrëse.
7. BQK-ja do të përpiloj në baza periodike një “udhëzues të shtesës” si referencë për të udhëhequr ushtrimin e gjykimit të saj në vendosjen e normës së shtesës kundërciklike në përputhje me paragrafin 8 të këtij neni. “Udhëzuesi i shtesës” do të reflektojë, në një mënyrë të kuptueshme, ciklin e kreditimit dhe rreziqet e ndërlidhura me rritjen e tepërt të kreditimit në Republikën e Kosovës, dhe do të marrë parasysh veçoritë specifike të ekonomisë kosovare. Ai do të bazohet në devijimin e raportit të kreditimit ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV-së) nga trendi i tij afatgjatë, duke marrë parasysh, ndër të tjera:
 - 7.1. një tregues të rritjes së niveleve të kreditit brenda Republikës së Kosovës dhe, në veçanti, një tregues që reflekton ndryshimet në raportin e kreditimit në vend ndaj BPV-së;

- 7.2. udhëzimet aktuale dhe rekomandimet/praktikat më të mira të lëshuara nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) dhe Bordin Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB) mbi vendosjen e normës së shtesës kundërciklike.
8. BQK-ja do të vlerësojë dhe vendosë normën e përshtatshme të shtesës kundërciklike të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni në baza periodike, duke marrë parasysh:
 - 8.1. “Udhëzuesin e shtesës” të përpiluar në përputhje me paragrafin 7 të këtij neni;
 - 8.2. Çdo udhëzim dhe rekomandim aktual të lëshuar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) dhe Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik (ESRB) mbi vendosjen e normës së shtesës kundërciklike;
 - 8.3. Variablat e tjera që i konsideron të rëndësishëm për adresimin e komponentës ciklike të rrezikut sistemik.
9. BQK-ja do të shpallë normën e shtesës kundërciklike përmes publikimit në faqen e saj të internetit. Njoftimi do të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - 9.1. norma e aplikuar e shtesës kundërciklike;
 - 9.2. udhëzuesin e shtesës të përmendur në paragrafin 7 të këtij neni;
 - 9.3. arsyetimin për normën e shtesës kundërciklike;
 - 9.4. kur norma e shtesës rritet, datën nga e cila bankat duhet të aplikojnë atë normë të rritur të shtesës për qëllime të llogaritjes së shtesës kundërciklike specifike për bankën. Data e aplikimit nuk do të jetë më vonë se 12 muaj pas datës kur është shpallur rritja e normës. Nëse data e aplikimit është më pak se 12 muaj pas shpalljes së rritjes së normës, ky afat i shkurtuar për aplikim do të justifikohet në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme;
 - 9.5. kur norma e shtesës zvogëlohet, pavarësisht nëse ajo zvogëlohet në zero, periudhën indikative gjatë së cilës nuk pritet rritje në normën e shtesës. Megjithatë, ajo periudhë indikative nuk do të përmbajë detyrim për BQK-në.
10. Për qëllimet e llogaritjes së shtesës kundërciklike për bankat me ekspozime në juridiksione të tjera, BQK-ja mund të miratojë një vendim mbi:
 - 10.1. Një normë të shtesës kundërciklike për atë vend në rastet kur nuk është vendosur dhe publikuar një normë e tillë nga autoriteti përkatës i juridiksionit përkatës, ose
 - 10.2. Një normë të ndryshme të shtesës kundërciklike për atë juridiksion nëse e konsideron se norma e vendosur nga autoriteti përkatës i juridiksionit përkatës nuk është e adekuate për t’i mbrojtur ato banka siç duhet nga rreziqet nga rritja e tepërt e kreditimit në atë juridiksion. Norma e vendosur nga BQK për juridiksionet tjera nuk do të jetë nën nivelin e vendosur nga autoriteti përkatës i juridiksionit përkatës, përveç nëse ajo normë e kalon shkallën prej 2.5%, e shprehur si përqindje e vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të peshuara me rrezik.
11. Në rast se një bankë nuk arrin të përmbushë plotësisht kërkesën sipas paragrafit 1 të këtij neni, ajo do t’i nënshtrohet kufizimeve mbi shpërndarjet e dividendës të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje. Në rast se zbatimi i këtyre kufizimeve mbi shpërndarjet e dividendës nuk sjell përmirësimin adekuat të kapitalit bazë të klasit të parë të bankës, BQK-ja mund të ndërmarrë masa shtesë në përputhje me Ligjin për Bankën Qendrore të Kosovës dhe Ligjin për Bankat, IMF dhe IFJB.

Neni 4

Shtesa për Institucionet Tjera me Rëndësi Sistemike (shtesa O-SII)

1. BQK do të identifikojë, në baza individuale, të nënkonsoliduara ose të konsoliduara, institucionet tjera me rëndësi sistemike (O-SII) të licencuara nga BQK në Republikën e Kosovës.
2. Institucionet me rëndësi sistemike do të jenë ato banka që, për shkak të rëndësisë së tyre sistemike, kanë më shumë gjasa të krijojnë rreziqe për stabilitetin financiar në Kosovë kur përballen me vështirësi financiare ose në rast të dështimit. BQK do të specifikojë metodologjinë për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike, duke u bazuar në udhëzimet aktuale nga Autoriteti Bankar Evropian dhe duke marrë parasysh veçoritë kombëtare.
3. Metodologjia do të përfshijë kriteret për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike dhe mënyrën e klasifikimit të tyre në nënkategori për të caktuar normën e shtesës O-SII deri në 3.5% të vlerës së përgjithshme të ekspozimeve të peshuara me rrezik.
4. Bazuar në metodologjinë e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, BQK të paktën një herë në vit do të identifikojë bankat me rëndësi sistemike, do t'i klasifikojë ato në nënkategori përkatëse dhe do të caktojë normat përkatëse të shtesës së kapitalit O-SII që secila bankë me rëndësi sistemike duhet të mbajë. Shtesa O-SII duhet të mbulohet nga kapitali bazë i klasit të parë.
5. BQK do të njoftojë përmes një vendimi secilën bankë me rëndësi sistemike mbi normën e shtesës O-SII që ato duhet të mbajnë.
6. BQK do të publikojë në faqen e saj të internetit informacione mbi metodologjinë që përdor për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike, dhe informacione tjera relevante sipas vlerësimit të saj.
7. Bankat nuk mund të përdorin kapitalin bazë të klasit të parë (CET 1) që mbahet për të plotësuar kërkesën sipas paragrafit 4 të këtij neni për të përmbushur asnjë nga kërkesat e vendosura sipas neneve 3 dhe 5 të kësaj Rregulloreje, apo ndonjë kërkesë shtesë të vendosur si pjesë e masave mbikëqyrëse.
8. Në rast se një bankë nuk arrin të përmbushë plotësisht kërkesën sipas paragrafit 4 të këtij neni, ajo do t'i nënshtrohet kufizimeve mbi shpërndarjet të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje. Nëse rast se zbatimi i këtyre kufizimeve mbi shpërndarjet nuk sjellë përmirësimin adekuat të kapitalit bazë të klasit të parë për bankën, BQK mund të ndërmarrë masa shtesë në përputhje me Ligjin për Bankën Qendrore të Kosovës dhe Ligjin për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të.

Neni 5

Shtesa për Rrezikun Sistemik

1. BQK mund të vendosë një shtesë kapitali për rrezikun sistemik për sektorin bankar ose për një apo më shumë segmente të këtij sektori, me qëllim të parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve sistemike apo makroprudenciale afatgjata jo-ciklike, që nuk janë të mbuluara nga nenet e tjera të kësaj Rregulloreje, në kuptimin e një rreziku të ndërprerjes në sistemin financiar që ka potencialin të ketë pasoja serioze negative për sistemin financiar dhe ekonominë reale në Kosovë. Kjo shtesë kapitali duhet të përmbushet me kapital bazë të klasit të parë (CET1).
2. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, bankat mund të kërkohen nga BQK të mbajnë një shtesë për rrezikun sistemik të paktën prej 1% të ekspozimeve për të cilat zbatohet kjo shtesë. Norma

mund të jetë e ndryshme për banka të ndryshme ose nën-grupe të bankave dhe mund të aplikohet mbi të gjitha ose vetëm një pjesë të ekspozimeve pa kufizim juridiksioni, në nivelin dhe mënyrën e përcaktuar nga BQK. Shkalla e shtesës për rrezikun sistemik do të jetë në hapa gradualë ose të përshpejtuar prej 0.5%, deri në një maksimum prej 3%. Pas vendosjes, norma e shtesës për rrezikun sistemik duhet të rishikohet të paktën çdo dy vjet.

3. Si përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni, BQK mund të caktojë një normë të shtesës për rrezikun sistemik më të lartë se 3% kur kjo është e justifikuar për qëllimin për të cilin është krijuar sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në raste të tilla, BQK do të japë një përshkrim të rrezikut sistemik që shtesa synon të adresoj dhe arsyet pse dimensionin e këtij rreziku kërcënon stabilitetin e sistemit financiar, përfshirë justifikimin pse asnjë nga masat e tjera ekzistuese në këtë Rregullore, veçmas ose në kombinim, nuk do të mjaftonin për të adresuar rrezikun e identifikuar. Justifikimi do të bëhet publik, përveç rasteve kur informacioni i dhënë konsiderohet të kërcënojë stabilitetin e sistemit financiar.
4. Bankat nuk mund të përdorin kapitalin bazë të klasit të parë (CET 1) që mbahet për të plotësuar kërkesën sipas paragrafit 2 të këtij Neni për të përmbushur asnjë nga kërkesat e vendosura sipas neneve 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje, apo ndonjë kërkesë shtesë të vendosur si pjesë e masave mbikëqyrëse.
5. Në rast se një bankë nuk arrin të përmbushë plotësisht kërkesën sipas paragrafit 2 të këtij Neni, ajo do t'i nënshtrohet kufizimeve mbi shpërndarjet e dividendës të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje. Nëse rast se zbatimi i këtyre kufizimeve mbi shpërndarjet e dividendës nuk sjellë përmirësimin adekuat të kapitalit bazë të klasit të parë për bankën, BQK mund të ndërmarrë masa shtesë në përputhje me Ligjin për Bankën Qendrore të Kosovës dhe Ligjin për Bankat, IMF dhe IFJB.

Neni 6

Kufizimet mbi shpërndarjet

1. Një bankë që përmbush kërkesën për shtesën e kombinuar të kapitalit (ang: Combined Buffer requirement - CBR) nuk duhet të bëjë shpërndarje të kapitalit bazë të klasit të parë në një masë që do të ulte nivelin e këtij kapitali në nivelin ku kërkesa për shtesën e kombinuar nuk përmbushet më.
2. BQK do të kërkojë që një bankë që nuk përmbush kërkesën për shtesën e kombinuar të kapitalit të llogarisë Shumën Maksimale të Shpërndarjes SHMSH (ang: Maximum Distributable Amount - MDA) në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, dhe të njoftojë BQK-në. Kur zbatohet paragrafi i parë i këtij neni, bankave u ndalohet të ndërmarrin cilëndo nga veprimet e mëposhtme para se të kenë llogaritur SHMSH-në:
 - 2.1. të bëjnë shpërndarje të kapitalit bazë të klasit të parë;
 - 2.2. të krijojnë një detyrim për të paguar shpërblime të ndryshueshme ose përfitime pensionale diskrecionale apo të paguajnë shpërblime të ndryshueshme, nëse detyrimi është krijuar kur banka nuk ka përmbushur kërkesat për shtesën e kombinuar të kapitalit;
 - 2.3. të bëjnë pagesa për instrumentet e kapitalit shtesë të klasit të parë.

3. Kur një bankë nuk përmbush ose tejkalon kërkesën për shtesën e kombinuar të kapitalit, i ndalohet të shpërndajë më shumë se SHMSH e llogaritur sipas paragrafit 4 të këtij neni, përmes ndërmarrjes së veprimeve të referuara në pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 të paragrafit 2 të këtij neni.
4. Bankat duhet të llogarisin SHMSH-në duke shumëzuar vlerën e llogaritur sipas paragrafit 5 të këtij neni, me faktorin e përcaktuar sipas paragrafit 6 të këtij neni. SHMSH duhet të zvogëlohet nga çdo veprim i referuar në pikat 2.1, 2.2 ose 2.3 të paragrafit 2 të këtij neni.

Tabela 1. SHUMA MAKSIMALE E SHPËRNDARJES -SHMSH

Vlera e fitimeve të ndërmjetme dhe vjetore, të përfshira në kapitalin bazë të klasit të parë (VF)	FAKTORI = Përqindja maksimale e shpërndarjes	SHUMA MAKSIMALE E SHPËRNDARJES (SHMSH)
VF	0%	$VF * \text{FAKTORI} = \text{Shuma maksimale e shpërndarjes (SHMSH)}$
VF	20%	$VF * \text{FAKTORI} = \text{Shuma maksimale e shpërndarjes (SHMSH)}$
VF	40%	$VF * \text{FAKTORI} = \text{Shuma maksimale e shpërndarjes (SHMSH)}$
VF	60%	$VF * \text{FAKTORI} = \text{Shuma maksimale e shpërndarjes (SHMSH)}$

5. Vlera që do të shumëzohet sipas paragrafit 4 të këtij neni, përbëhet nga:
 - 5.1. Fitimet e ndërmjetme të pa përfshira në kapitalin bazë të klasit të parë sipas Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, të krijuara që nga vendimi më i fundit mbi shpërndarjen e fitimeve ose çfarëdo nga veprimet e referuara në pikat 2.1, 2.2 ose 2.3 të paragrafit 2 të këtij neni;
 - 5.2. Fitimet vjetore të pa përfshira në kapitalin bazë të klasit të parë sipas Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, të krijuara që nga vendimi më i fundit mbi shpërndarjen e fitimeve ose çfarëdo nga veprimet e referuara në pikat 2.1, 2.2 ose 2.3 të paragrafit 2 të këtij neni; **minus**
 - 5.3. Shumat që do të paguheshin për taksa nëse dispozitat e përcaktuara në pikat 5.1 dhe 5.2 të këtij paragrafi do të mbaheshin.
6. Faktori përcaktohet si më poshtë:
 - 6.1. Kur kapitali bazë i klasit të parë i mbajtur nga banka, i cili nuk përdoret për të përmbushur kërkesat e kapitalit rregullator sipas Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, i shprehur si përqindje ndaj vlerës së ekspozimeve të peshuara me rrezik të llogaritura sipas paragrafit 5 të nenit 5 të së njëjtës rregullore, është brenda intervalit të parë (më të ulët) të kërkesës për shtesën e kombinuar, faktori është 0;

6.2. Kur është brenda intervalit të dytë, faktori është 0.2;

6.3. Kur është brenda intervalit të tretë, faktori është 0.4;

6.4. Kur është brenda intervalit të katërt (më të lartë) të kërkesës për shtesën e kombinuar, faktori është 0.6.

Kufijtë e poshtëm dhe të sipërm të secilit interval të shtesës së kombinuar të kapitalit llogariten si vijon:

Kufiri i poshtëm i intervalit = $(\text{Kërkesa për shtesën e kombinuar})/4 \times (Q_n-1)$

Kufiri i sipërm i intervalit = $(\text{Kërkesa për shtesën e kombinuar})/4 \times Q_n$;

Ku "Qn" paraqet numrin rendor të intervalit përkatës.

Tabela 2.

Intervali i Shtesës së Kombinuar të Kapitalit (SHKK) ku pozicionohet $VF = \text{Shtesa e Kombinuar e Kapitalit SHKK}/4 * Q_n - 1$ Për shembull: Nëse vlera e fitimeve të ndërmjetme dhe vjetore të papërfshira në kapitalin bazë të klasit të parë (VF), rezulton në intervalin 25% deri në 50% të nivelit të shtesës së kombinuar të kapitalit (SHKK), atëherë lejohet shpërndarje deri në 20% e VF-së (si dividendë).	FAKTORI = Përqindja maksimale e shpërndarjes
Intervali 1 0%-25% e nivelit të SHKK-së	0%
Intervali 2 >25% - 50%	20%
Intervali 3 >50% - 75%	40%
Intervali 4 >75% - 100%	60%

7. Kufizimet e vendosura nga ky nen vlejnë vetëm për pagesat që sjellin ulje të kapitalit bazë të klasit të parë ose ulje të fitimeve dhe në rastet kur pezullimi ose moskryerja e pagesave nuk përbën ngjarje të dështimit ose kusht për fillimin e procedurave sipas kërkesave të likuidimit të aplikueshme për bankën.

8. Kur një bankë nuk përmbush kërkesën për shtesën e kombinuar të kapitalit dhe paraqet kërkesë në BQK për miratim të shpërndarjes së çfarëdo fitimi të shpërndarshëm ose për të ndërmarrë një nga veprimet e referuara në pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 të paragrafit 2 të këtij neni, ajo duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm në BQK:

8.1. vlerën e kapitalit të mbajtur nga banka, të ndarë si më poshtë:

8.1.1. kapitali bazë i klasit të parë;

8.1.2. kapitali shtesë i klasit të parë;

- 8.1.3. kapitali i klasit të dytë;
- 8.2. vlerën e fitimeve të ndërmjetme dhe fitimeve të fund-vitit;
- 8.3. SHMSH-në e llogaritur sipas paragrafit 4 të këtij neni;
- 8.4. vlerën e fitimeve të shpërndarshme që banka synon të alokojë ndërmjet pikave në vijim:
 - 8.4.1. pagesat e dividendës;
 - 8.4.2. riblerjen e aksioneve (share buybacks);
 - 8.4.3. pagesat për instrumentet e Kapitalit shtesë të klasit të parë;
 - 8.4.4. pagesat e shpërblimeve të ndryshueshme ose përfitimeve pensionale diskrecionale, qoftë përmes krijimit të një detyrimi të ri për pagesë ose përmes pagesës sipas një detyrimi të krijuar kur banka nuk ka përmbushur kërkesat për shtesën e kombinuar.
9. Bankat duhet të mbajnë procedura për të siguruar që vlera e fitimeve të shpërndarshme dhe SHMSH të llogariten në mënyrë të saktë dhe duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë saktësinë e tyre në rast të kërkesës nga BQK.
10. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, një shpërndarje në lidhje me kapitalin bazë të klasit të parë përfshinë:
 - 10.1. Një pagesë të dividendës në të holla;
 - 10.2. Shpërndarjen e bonus aksioneve të paguara plotësisht ose pjesërisht, ose instrumenteve të tjera të kapitalit të referuara në nenin 7 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;
 - 10.3. Riblerjen ose blerjen nga një bankë të aksioneve të veta ose instrumenteve të tjera të kapitalit të referuara në nenin 7 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;
 - 10.4. Rimbursimin e shumave të paguara në lidhje me instrumentet e kapitalit të referuara në nenin 7 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;
 - 10.5. Shpërndarjen e artikujve të referuar në nenin 7 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.

Neni 7

Plani i Ruajtjes së Kapitalit

1. Nëse një bankë nuk arrin të përmbushë kërkesën e saj për shtesën e kombinuar të kapitalit, ajo duhet të përgatisë një plan të ruajtjes së kapitalit dhe ta paraqesë atë në BQK jo më vonë se pesë ditë pune pas identifikimit se nuk po e përmbush këtë kërkesë, përveç nëse BQK autorizon një periudhë më të gjatë prej maksimum 10 ditë. BQK do të japë autorizime të tilla vetëm mbi bazën e situatës individuale të bankës dhe duke marrë parasysh shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj.
2. Plani i ruajtjes së kapitalit duhet të përfshijë si vijon:
 - 2.1. vlerësimet e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe një parashikim të bilancit të gjendjes;
 - 2.2. masa për të rritur normat e kapitalit të bankës;

- 2.3. një plan dhe afat kohor për rritjen e kapitalit bazë të klasit të parë me qëllim përmbushjen e plotë të kërkesës për shtesën e kombinuar të kapitalit;
- 2.4. çdo informacion tjetër që BQK e konsideron të nevojshëm për kryerjen e vlerësimit të referuar në paragrafin 3 të këtij neni.
3. BQK do të vlerësojë planin e ruajtjes së kapitalit dhe do ta miratojë planin vetëm në rastin kur konsideron se me zbatimin e tij, banka ka gjasa të arsyeshme të ruajë ose të rrisë kapitalin e mjaftueshëm për t'i mundur përmbushjen e kërkesave për shtesën e kombinuar të kapitalit brenda një periudhe që BQK e konsideron të përshtatshme.
4. Nëse BQK nuk miraton planin e ruajtjes së kapitalit në përputhje me paragrafin 3, ajo do të imponojë një ose të dyja nga masat e mëposhtme:
 - 4.1. të kërkojë nga banka që të rrisë kapitalin bazë të klasit të parë në nivele të caktuara brenda periudhave të përcaktuara;
 - 4.2. të ndërmarrë masa shtesë në përputhje me Ligjin për BQK-në dhe Ligjin për Bankat, IMF-të dhe IFJB-të.

Neni 8

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat, IMF dhe IFJB.

Neni 9

Dispozitat përfundimtare

1. Shtesa makroprudenciale e përcaktuar në Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, referuar si Kapitali Shtesë i Kapitalit Bazë (angl: Capital Conservation Buffer), mbetet në fuqi dhe aplikohet në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e asaj rregulloreje.
2. Rregullorja për Shtesat Makroprudenciale të Kapitalit përcakton të gjitha shtesat tjera të kapitalit në kuadër të mbikëqyrjes makroprudenciale.
3. Mbeten në fuqi dhe nuk afektohen aktet juridike (vendimet/urdhërat), të nxjerra nga BQK para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, për Zbatimin e Instrumenteve Makroprudenciale - Shtesa Pozitive Neutrale Kundërciklike e Kapitalit dhe Shtesa e Kapitalit për Bankat me Rëndësi Sistemike.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me datën 1 maj 2025.

Dr. Sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës